



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:154732
Datë: 16.01.2024
Numri i dokumentit: 05193882

C-IV-23-0124

Parashtruesi i kërkesës

Autoriteti i Likuidimit (AL), NSH “G.T. Grafikos”- Gjilan, (GJI082) në likuidim
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. “Dritan Hoxha” nr.55 Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtari Gazmend Sylaj, me 16 janar 2024, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- Aprovohet Raporti Përfundimtar i Autoritetit të Likuidimit të NSH “G.T. Grafikos”- Gjilan.**
- Lejohet mbyllja e rastit të likuidimit ndaj NSH “G.T. Grafikos”- Gjilan.**
- Lirohet Autoriteti i Likuidimit nga çdo detyrë e mëtutjeshme në lidhje me procedurat e likuidimit ndaj NSH “G.T. Grafikos”- Gjilan.**
- Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 13 korrik 2023, pranë DHPGJS, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar Raportin Përfundimtar të mbylljes së procesit të likuidimit të NSH “G.T. Grafikos”- Gjilan- GJI082 (tani e tutje subjekti raportues), pasi që ka ardhur në përfundim që kooperativa nuk ka asete te realizueshme, se janë përmbushur të gjitha kërkesat kreditore të vlefshme si dhe nuk ka ankesa të regjistruara pranë DHPGJS.

Andaj AL propozoj gjykatës që në pajtim me nenin 43 dhe nenin 46 të Shtojcës së Ligjit (nr. 04/L-034) për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tutje: Shtojca e Ligjit të AKP-së) pas shqyrtimit të kërkesës të aprovojë Raportin Përfundimtar të dhe të merr vendim mbi lejimin e

mbylles së rastit të likuidimit ndaj kësaj ndërmarrje si dhe AL të lirohet nga çfarëdo detyre të mëtejme lidhur me subjektin e këtij raporti përfundimtar.

Për detaje të tjera referohet shkresave të lëndës.

Arsyetimi ligjor

DHPGJS, pas shqyrtimit të kërkesës, konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore sipas kërkesës së AL.

Sipas nenit 43 paragrafi 1, të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylles së rastit të Likuidimit, i parashtrohet për informim raportin përfundimtar Bordit të Drejtorëve, para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë nga Autoriteti i Likuidimit.

Paragrafi 2 i nenit 43 përcakton se Raporti përfundimtar përmban:

- 2.1. një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera,
- 2.2. një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme,
- 2.3. një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara,... dhe
- 2.4. një listë të balancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit;

Paragrafi 3 i shtojcës së Ligjit bazik po ashtu i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) përcakton se: *Autoriteti i Likuidimit brenda pesë (5) ditëve do të shpall në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, Raportin Përfundimtar të aprovuar nga Gjykata për mbylljen e rastit të likuidimit të ndërmarrjes.*

Neni 44 paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, parasheh që përveç rasteve të rregulluara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, mbyllja e rastit ndodh kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce.

Autoriteti i Likuidimit ka dorëzuar Raportin Përfundimtar për aprovim përfshirë dëshmitë në vijim që janë shqyrtuar nga gjykata.

Me 1 shkurt 2007 Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit – AKM (paraardhësja ligjore e AKP) nxjerr vendim për likuidimin e NSH-së gjersa me 16 nëntor 2007 dhe përfundimisht me vendimin 1 nëntor 2022 ka emëruar respektivisht ri-emëruar anëtarët e Autoritetit të Likuidimit për subjektin e këtij raporti Për më tepër, në shkresa të lëndës të bashkangjitura me kërkesë (shtojca 3 dhe 4 e Raportit).

Me 7 dhe 11 shkurt 2008 Autoriteti i Likuidimit ka publikuar njoftimet për fillimin e procesit të likuidimit, njoftime këto të publikuara në shtypin ditor. Po ashtu, AL ka dërguar njoftimet përkatëse për fillimin e Likuidimit të kësaj NSH-je tek institucionet relevante, si:

- Gjykatës Komunale në Gjilan,
- Gjykatës së Qarkut në Gjilan,
- Gjykatës Ekonomike në Prishtinë,
- DHPGJS, dhe

- Zyrës së Regjistrimit të bizneseve të Kosovës.

më tepër, në shkresa të lëndës të bashkangjitura me kërkesë (shtojca 5 e Raportit).

Sipas Shtojcës 6, është parashtruar pasqyra e shpenzimeve të procedurave të likuidimit të subjektit raportues.

Raportit, nga ana e AL, i është bashkangjitur një listë prej 290 kërkesave kreditore ndaj subjektit raportues të cilat kërkesa sipas AL janë përmbushur (shtojca 7 e Raportit).

Nga të dhënat e DHPGJS, gjer maj 2023, AL nuk ka pranuar ndonjë të dhënë nëse ka ndonjë kërkesë të regjistruar dhe shkresa konfirmuese nga DHPGJS (Shtojca 8 dhe 13 e Raportit).

Nga të dhënat e raportit, shihen lista e asetëve të privatizuara të subjektit raportues, si fabrika dhe lokal (Shtojca 9 e Raportit).

Nga të dhënat e raportuara e sipas arkivit të po këtij subjekti nuk ka asete tjera ndaj të cilave është hequr dorë (Shtojca 10 e Raportit).

Është parashtruar pasqyra përmbledhëse financiare e llogarisë bankare në likuidim, të subjektit raportues, në të cilën janë pasqyruar të hyrat e gjithmbarshme, shpenzimet dhe mjetet e mbetura të bartura në buxhetin e Kosovës si dhe lista e pranimeve dhe pagesave nga llogaria bankare e subjektit raportues në likuidim (Shtojca 11 dhe 12 e Raportit).

Përfundimisht AL me kërkesë parashtrorj raportin përfundimtar të shpërndarjes për kreditorët e subjektit raportues (Shtojca 14 e Raportit).

Nga të cekurat si më lartë, gjykata konstaton se Agjencia Kosovare e Privatizimit përkatësisht Autoriteti i Likuidimit i ka ndërmarr të gjitha veprimet dhe vendimet e nevojshme për mbylljen e rastit të likuidimit të kësaj NSH-je, në pajtim me ligjin, andaj aprovon Raportin Përfundimtar të NSH-së dhe lejon mbylljen e rastit të likuidimit të kësaj NSH-je.

Me këtë ndërpritet ekzistimi i kësaj ndërmarrje dhe rasti mbyllet.

AL i mbetet në përgjegjësi për veprimet apo lëshimet jologjore gjatë mandatit të tij, të parapara sipas nenit 46.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet gjyqësore

Parashtruesi i kërkesës ka bërë pagesën e taksës gjyqësore dhe nuk caktohen shpenzimet tjera procedurale.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar